



KOLEGJI AAB – PRISHTINË
Programi Komunikim Masiv dhe Gazetari (MA)
Dekanatit

Programi për Studimet: Master

Emri i programit te Masterit: Gazetari dhe komunikime mediale

Lënda: Kërkesë për lejimin e punimit te diplomës, tezat dhe projekt temën e masterit

Kandidati: Imer Pantina nga Klina

Titulli i Temës: NDËRVEPRIMI I LETËRSISË NË MEDIAT E SHKRUARA NË KOSOVË

Propozimi për mentor: Prof. Asoc. Dr. Ibrahim Berisha

Përshkrimi i shkurtër i temës:

Qasja ndaj temës *NDËRVEPRIMI I LETËRSISË NË MEDIAT E SHKRUARA NË KOSOVË* së pari nënkupton studimin e efekteve që jep letërsia tek mediat e shkruara qoftë edhe përmes një periudhe kohore. Duke pasur parasysh se lidhshmëria mes tyre është gati e pashmangshme, atëherë mendojmë se është e rëndësishme t'i shohim disa nivele efektive që letërsia lë në gzaetari. Format shkrimore të shumëllojshme që kanë letërsia dhe gazetaria gjejnë pikëtakimet dhe dallimet mes tyre, dhe, mendoj unë, është e rëndësishme që t'i njohim disa prej tyre përmes këtij studimi duke e ekspozuar shkrimin gazetaresk përballë analizës dhe lidhjes së tij me format e letërsisë.

Lidhja historike që kanë këto dy fenomene dhe lidhja kronologjike e vazhdueshme kohore e ndërveprimit shtrojnë nevojën e përzgjedhjes, apo më mirë të themi, ngushtimit të temës në hapësirën kohore dhe të disa fenoeneve të veçanta, që mendojmë se paraqesin rëndësi për studim.

Në kontekstin e përgjithshëm kulturor, fenomeni letrar i gazetarisë zë një vend të veçantë dhe ushqen shijet e shumë lexuesëve, por, për të parë se si shprehet kjo në disa media dhe në disa ditë, do të zërthejmë tekstin gazetaresk dhe do të japim analizat tona dhe do t'i argumentojmë edhe me mendime teorike të teoricientëve të ndryshëm.

Prishtinë, 2015

Nënshkrimi i kandidatit